

# ZHVENDOSJA E KUFIJVE ME EVROPËN KREATIVE

NGA NJË SFIDË LOKALE NË NJË PROJEKT EVROPIAN



# Hyrje

Evropa Kreative është një program i Bashkimit Evropian që u mundëson organizatave dhe individëve nga sektori kulturor, kreativ, i filmit dhe audiovizual, t'i zhvillojnë idetë lokale në projekte evropiane me ndikim afatgjatë.

Një ide mund të fillojë në mënyrë personale, pra në nivel lokal:

- një koreografe dëshiron që vallëzimi të arrijë te grupe të reja sociale
- një regjisor eksploron histori të patreguara për filmin e tij të ri
- një media publike eksploron se si të bëhet më e qëndrueshme dhe më e besueshme
- një ekip kreativ që synon të ringjallë trashëgiminë kulturore përmes formateve digjitale

Evropa Kreative mundëson që këto ide të zhvillohen përmes partneriteteve, shkëmbimit të njohurive dhe krijimit të përbashkët. Projektet e mbështetura nga nën-programet **Kulturë, MEDIA** dhe **Ndërsektoriale** kontribuojnë për një hapësirë kulturore dhe audiovizive evropiane gjithëpërfshirëse, inovative dhe rezistente.

# Nga një sfidë lokale drejt një ideje projekti

Çdo projekt evropian fillon me një sfidë të identifikuar qartë. Mund t'i referohet një qasje të kufizuar në përmbajtje kulturore, publik të pamjaftueshëm të zhvilluar, mungesë burimesh ose nevojë për aftësi dhe metodologji të reja.

Kur e njëjta sfidë shfaqet në qytete dhe vende të tjera të Evropës Kreative, ajo fiton rëndësi evropiane. Përmes ndarjes së përvojave, krahasimit të praktikave dhe zhvillimit të përbashkët të zgjidhjeve, nis bashkëpunimi evropian.

Për shembull:

- Si mund të bëhet vallëzimi më i qasshëm për grupet e cenueshme?
- Si të zhvillohet një audiencë e re për filmin evropian tek të rinjtë?
- Si të përgjigjen mediat ndaj sfidave të lajmeve të rreme?

Evropa Kreative krijon një hapësirë ku sfidat lokale shndërrohen në ide evropiane të përbashkëta, metodologji dhe modele të reja të aplikueshme në disa vende.



# Imagjino · Krijo · Shpërndaj

Zhvillimi i një projekti evropian mund të shihet  
përmes tre hapave kryesorë:

## Imagjino

Gjithçka fillon me një ide për ndryshim. Për shembull, një organizatë lokale vëren se të rinjtë përballen me stres dhe ankth, ndërsa programet kulturore për mirëqenie mendore pothuajse nuk ekzistojnë. Organizata imagjinon aktivitete kulturore që do të mbështesin mirëqenien mendore, duke krijuar hapësirë për shprehje, mësim dhe lidhje të ndërsjellë.

## Krijo

Bashkë me partnerë evropianë organizohen punëtori për terapi përmes artit, seanca për rrëfimin e tregimeve lokale dhe formate digjitale që lidhin përvojat dhe ekspertizat e ndryshme. Aktivitetet mbështesin shëndetin mendor dhe testohen dhe përshtaten me ndihmën e partnerëve nga vendet e tjera.

## Shpërndaj

Projekti bëhet evropian kur rezultatet dhe metodologjitë zbatohen edhe në vende të tjera. Formatet e zhvilluara përshtaten me kontekste të ndryshme kulturore dhe arsimore, duke krijuar efekt afatgjatë dhe rrjete të reja të bashkëpunimit transnacional. Iniciativa lokale shndërrohet në inovacion evropian me zbatim të gjerë.



# Kur bëhet ideja evropiane?

Ideja bëhet evropiane kur një sfidë e përbashkët njihet në vende dhe mjedise të ndryshme dhe kur rezultatet sjellin vlerë jashtë komunitetit lokal. Për shembull, një shkollë e vogël muzikore rurale vëren se të rinjtë nga kultura të ndryshme kanë qasje të kufizuar në aktivitete të përbashkëta muzikore. Duke u lidhur me shkolla të ngjashme nga vendet e tjera, ata zhvillojnë metoda multikulturore që mund të zbatohen edhe në zonat urbane, duke nxitur mësimin ndërkulturor. Një regjisor i pavarur lokal vëren se audienca e re rrallë shikon filma evropianë artistikë ose dokumentarë. Bashkë me partnerë nga vende të tjera, krijohen platforma dhe programe online për shfaqje dhe diskutime, të cilat mund të përshtaten në mjedise të ndryshme arsimore dhe kulturore.

Vlera evropiane nuk arrihet vetëm me përfshirjen e partnerëve nga vende të ndryshme, por përmes ndarjes së sfidës së përbashkët, krijimit të modeleve të reja dhe ndikimit në kontekstin më të gjerë evropian. Iniciativat e tilla hapin idenë lokale drejt një dialogu transnacional, njohurive të reja dhe ndikimit afatgjatë.



# Çfarë NUK është projekt evropian?

Çdo aktivitet ndërkombëtar nuk përbën një projekt evropian. Vetëm prania gjeografike e partnerëve nga vende të tjera në programin Evropa Kreative nuk mjafton nëse ata nuk kanë një rol thelbësor. Projekti nuk krijon vlerë të shtuar evropiane kur:

- partnerët përfshihen vetëm formalisht
- tema nuk paraqet një sfidë të përbashkët, ose
- rezultatet mbeten të kufizuara në kontekstin lokal

Për shembull, një koncert ndërkombëtar nuk përbën një projekt me vlerë të shtuar evropiane nëse muzikantët nga vende të ndryshme thjesht performojnë së bashku, pa marrë pjesë aktive në zhvillimin e programit dhe vizionit të përbashkët artistik. Një festival ndërkombëtar filmi nuk konsiderohet projekt evropian nëse marrin pjesë vetëm të ftuar nga vendet e programit Evropa Kreative, ndërsa nëse programi i festivalit nuk është zhvilluar në bashkëpunim me partnerë evropiane të rëndësishëm, përkatësisht nuk është në përputhje me prioritetet dhe qëllimet e Evropa Kreative për festivalet filmike evropiane.

Një projekt evropian ekziston kur partnerët ndërtojnë së bashku përmbajtjen, metodologjinë dhe rezultatet – dhe kur këto rezultate kanë potencial të vazhdojnë edhe pas përfundimit të projektit, duke krijuar një vlerë afatgjatë transnacionale.

# Tema të ndërlidhura: Vlerat evropiane në praktikë

Prioritetet horizontale të Evropa Kreative janë një pjesë integrale e projekteve, në masën që ato parashikohen në vetë veprimet.

## Tranzicioni i gjelbër

Projektet promovojnë qëndrueshmëri përmes udhëtimeve ekologjike, bashkëpunimit digjital dhe përdorimit të materialeve të ricikluara. Për shembull, një festival ndërkombëtar i artit rrugor organizon transmetime të punëtorive online, ndërsa artistët përdorin materiale për krijim nga objekte të ricikluara.

## Barazia gjinore

Sigurohet përfaqësim i barabartë i autorëve, artistëve dhe kuratorëve në aktivitetet e projekteve. Për shembull, një projekt filmik përfshin në mënyrë të barabartë regjisorw nga të dyja gjinitë dhe nxit diskutime mbi stereotipet gjinore në prodhimin filmik.

## Diversitet dhe inkluzion

Projektet janë të hapura për nevoja të ndryshme të përdoruesve. Për shembull, një dizajn eksperimental i karrigeve dhe hapësirave të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara u mundëson të gjithë vizitorëve të marrin pjesë aktivisht në aktivitete kulturore, duke krijuar një mjedis gjithëpërfshirës dhe të larmishëm.

Integrimi i këtyre temave forcon rëndësinë, cilësinë dhe dimensionin evropian të projekteve.



# Buxheti: një histori evropiane në numra

Buxheti është më shumë se një formular Excel – ai tregon historinë se si një ide shndërrohet në aktivitete konkrete, rezultate dhe të arritura. Një buxhet i strukturuar mirë tregon se projekti është i realizueshëm, se aktivitetet janë të planifikuara realisht dhe se fondet e kërkuara janë të justifikuara dhe të nevojshme për të arritur objektivat.

Në kuadër të programit Evropa Kreative, vetëm kostot reale të bëra gjatë projektit dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar janë të pranueshme. Megjithëse granti bazohet në një shumë të përgjithshme, çdo kosto duhet të jetë specifike, e verifikueshme dhe e lidhur drejtpërdrejt me aktivitetet.

Shembuj:

- Artet performuese: prova, paraqitje, prodhim teknik.
- Literatura: honorarë për përkthyes, redaktim, dizajn dhe botim.
- Filmi: ide, hulumtim, skenar, prodhim, post-produksion dhe shpërndarje.

Buxheti i projektit duhet të jetë:  
**real, proporcional, transparent, i lidhur drejtpërdrejt me idenë dhe aktivitetet e projektit**



# Udhëzime të përgjithshme për përgatitjen e një projekti të suksesshëm

- **Pajtueshmëria me thirrjen** – ideja duhet të korrespondojë drejtpërdrejt me objektivat, prioritetet dhe kriteret e thirrjes.
- **Një ide e qartë dhe inovative** – e zhvilluar në mënyrë logjike, me format, metodologji ose qasje të reja ndaj publikut.
- **Vlera e shtuar evropiane** – rezultatet dhe njohuritë janë të zbatueshme jashtë kontekstit kombëtar.
- **Partneriteti dhe bashkëpunimi** – secili partner ka një rol të qartë dhe kontribut konkret, me njohuri plotësuese.
- **Aktivitete me rezultate të matshme** – çdo aktivitet çon në rezultate specifike.
- **Buxheti** – real, i justifikuar, proporcional dhe i lidhur ngushtë me aktivitetet, përkatësisht arritjet dhe rezultatet.
- **Tema të ndërlidhura** – tranzicioni i gjelbër, barazia gjinore, diversiteti dhe inkluzioni të integruara në mënyrë praktike.
- **Komunikimi dhe shpërndarja** – strategji të qarta të zhvilluara
- **Qëndrueshmëria** – rezultatet vazhdojnë pas përfundimit të projektit.
- **Korrektësia administrative** – aplikimi i dorëzuar në mënyrë të rregullt dhe në kohë, sipas udhëzimeve



Creative Europe  
2021-2027

PUSH  
BOUNDARIES

#CreativeEurope

Botues: Ministria e Kulturës dhe Turizmit, Zyra e Evropës Kreative - Shkup

Rreth botuesit: Zoran Ljutkov, Ministër i Kulturës dhe Turizmit

Editor: mr. Biljana Prentoska

Titulli i originalit:

„ Поместуваме граници со Креативна Европа Од локален предизвик до европски проект“

Tekste

Materialet e punës së Njësisë për Evropë Kreative, Komisioni Evropian -Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, Agjencia Ekzekutive për Arsim dhe Kulturë pranë Komisionit Evropian

Përkthyer nga gjuha maqdone ne gjuhen shipe: Final Fiction

Redaktim gjuhësor: Vojsa Taipitop of Form

Dizajn grafik pregaditi: Studentski servis – Skopje

Република Северна Македонија



Republika e Maqedonisë së Veriut

Министерство за култура и туризам

Ministria e Kulturës dhe e Turizmit



Канцеларија на  
креативна европа МК



Копинансирано од  
Европска Унија

*Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Zyra e Evropës Kreative) dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian*

Lidhje të dobishme:

Zyra e Creative Europe MK [www.ced.mk](http://www.ced.mk)  
Komisioni Evropian, Programi Creative Europe:  
<https://culture.ec.europa.eu/creative-europe>

---

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

341.232.7(4-672EY)(041)

ZHVENDOSJA e kufijve me Evropën Kreative [Електронски извор]: nga një sfidë lokale në një projekt evropian / [editor Biljana Prentoska]. - Shkup : Ministria e kulturës dhe turizmit, Zyra e Evropës Kreative, 2025

Начин на пристапување (URL): . - Превод на делото: Поместуваме граници со Креативна Европа : од локален предизвик до европски проект. - Текст во PDF формат, содржи [10] стр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 24.12.2025

ISBN 978-608-4544-52-4

а) Европска Унија -- Програма "Креативна Европа" -- Културна соработка -- Брошури  
COBISS.MK-ID 67791365

---